



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 491 prot.

Fushë-Arrëz, më 20.02.2026

NJOFTIM

PËR MBLEDHJE TË KËSHILLIT TË BASHKISË DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz,

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, si dhe Rregullores për funksionimin e Këshillit të Bashkisë, në bazë të mbledhjes së Kryesisë së Këshillit të datës 16.02.2026, njoftoheni se mbledhja radhës e Këshillit të Bashkisë për muajin **Shkurt 2026** zhvillohet, **ditën e premte, datë 27.02.2026, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak** me rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak, datë 27.02.2026.
2. *Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 30.01.2026.*
3. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike si minimum jetik duke përdorur 6 % të fondit total të ndihmës ekonomike për muajin Janar 2026.
4. *Projektvendim për një ndryshim në VKB Nr.43, datë 26.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së bashkisë Fushë-Arrëz, Njësie Administrative, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2026".*
5. Projektvendim për një shtesë dhe ndryshim në VKB Nr. 47, datë 26.12.2025 "Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2026-2028, buxhetin e vitit 2026, si dhe kalendarin buxhetor për vitin 2026".
6. *Projektvendim për rishqyrtimin e VKB Nr. 50, datë 26.12.2025 "Për Dhënie në Përdorim Fondi Pyjor Publik, Loti 1- Në Ekonominë Pyjore Kryezi, Qafë-Plakë-Qafë-Shari, Sakat-Lak Hithi për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej; 1.4375 Ha; Loti 2 - Në Ekonominë Pyjore Breg Drini, Mertur-Guri, Lumi Berishës për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej 1.5625 Ha; Loti 3 - Në Ekonominë Pyjore Breg-Drini, Iballe-Mezi 1 & 2, Lumi i Berishës, Qafë Plakë -Qafë Shari për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej; 1.7500 Ha në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz".*
7. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
8. *Të ndryshme.*

MBLEDHJE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME

- a) Mbledhja e Komisionit të Mirëqenies Sociale, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut (**Franc Doda, Tereze Dema, Pavlin Qafa**), ditën e **mërkurë**, datë **25.02.2026, ora 10:00** në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **3** të rendit të ditës.
- b) *Mbledhja e Komisionit të Ekonomisë, Financave, Buxhetit, Mbikqyrjes Financiare, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, (Franc Doda, Valentin Doçi, Valentina Lleshaj, Besjana Marku, Zef Cara), ditën e mërkurë, datë 25.02.2026, ora 10:30, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën 4 dhe pikën 5 të rendit të ditës.*
- c) Mbledhja e Komisionit të Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Turizmit, Mbrojtjes së Mjedisit (**Mustaf Pashkaj, Nikolin Sadikaj, Pavlin Qafa**) ditën e **mërkurë**, datë **25.02.2026, ora 11:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **6** të rendit të ditës.

Duke kërkuar korrektësinë tuaj për pjesëmarrjen në mbledhjet e komisioneve dhe mbledhjen plenare të Këshillit të Bashkisë!

SEKRETAR
Naze SELIMAJ